



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA KOLONJE**

*Adresa:* Bashkia Kolonje "Sheshi Rilindja" 7401 Erseke, Kolonje Albania, *Web:* [www.kolonja.gov.al](http://www.kolonja.gov.al), *Email :* info@kolonja.gov.al

**PROCESVERBALI I TAKIMIT DATE: 14 SHTATOR 2022**

**VENDI:** *Biblioteka e Qytetit, Qender Erseke*

**ORA:** *11:00*

**Tema e Konsultimit:** *Mbledhja e Rekomandimeve per prioritetet e komunitetit per hartimin e buxhetit per vitin 2023.*

**Baza Ligjore:** *Ne mbeshtetje dhe ne zbatim te Ligjit Nr.146/2014 "Per njoftimin dhe Konsultimin Publik" neni 11 pika 2, Ligji Nr. 139/2015 " Per veteqeverisjen vendore" neni 34, Ligji Nr.68 /2017 "Per financat e veteqerisjes vendore", ligji nr.9936, date 26.06.2088, "Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republiken e Shqiperise", te ndryshuar,ligji nr. 10296, date 08.07.2010 "Per menaxhimin financier dhe kontrollin" i ndryshuar*

**Pjesemarres Kryetari I Bashkise Z. Erion Isai, Nenkryetar Z.Aldo Jaho, Drejtor i sherbimeve Ermal Zylfo, Administratori i njesise Qender-Erseke Pando Cunge, Drejtor i bordit te kullimit Sotiris Ver, drejtori i Bujqesise Ganiart Eminaj,**

*Per realizimin e buxhetit, puneve dhe detyrave ne njesine Qender , kete 8 mujor dhe cfare do te behet tre viter e ardhshme. Morren pjese te gjithe kryepleqte e fshtrave te njesise Qender dhe familjare te fshatrave te ndryshem.*

Takimin e hapi kryetari i bashkise z.Erion Isai i cili prezantoi punet e bera ne keto fshtra per vitin 2022, kryesisht furnizimin e tyre me uje te pijshem ne fshatrat Bejkove, Starje Lahollare, Selenice, Kreshove, Tac Poshte, Tac Lart, Tac Qender, Gjonic Borove, Rehove, Psar. Jane bere kanalet vadite se dhe kulluese dhe njekohesisht po vazhdon mirembajtja e rrugeve.

Per PBA 2023-2025 eshte planifikuar rikonstruksioni i qendres se Mollasit.

- **Kryeplaku i fshatit Bejkove**

Petro Xhomaqi

Na duhet rruga ne fshatin Bejkove, uji i pijshem eshte problem i madh, pasi fshati nuk furnizohet me uje. Problem eshte dhe transporti per nxenesit e shkolles pasi duhet nje makine.

- Kryeplaku i fshatit Gjонc
- Aliu Gjонc

Kemu problem uren e Prodamit pasi nuk kalojne as njerez as makina. Na duhen 50 m tubo per kanalin ne lagjia e pare ne Gjонc.

- **Kryeplaku i fshatit Selenice**

Engjell Jaho

Problem vazhdon te ngelet uji i vaditjes me fshatin Kreshove. Shumica e kullotave ne fshatin Selenice jane pa uje e pa kanale vadites. Duhet hapur kanali 100 m qe na lidh me Vadicen.

- **Kryeplaku Lengez**

Fredi Rupi

Problemi i madh eshte furnizimi me uje te pijshem pasi ky fshat nuk eshte i lidhur me ujesellsin e Kozelit. Rruga eshte cope cope duhet shtruar , kanalet vadite se duhen bere.

- **Starje Kaskollare**

Mydin Kacolli

Problem ngelet uji i pijshem pasi vjen i piset neper cezma. Shkarkimi i depos eshte shume keq. Rruga me kaskollare nuk eshte mirembajtur fare, ujerat e zeza dalin neper rruge dhe eshte e pamundur te kalosh ne rruge nga era e keqe e tyre. Kerkojme nje rruge per ne varrezat sepse nuk shkohet ne to.

- **Starje Euljon Kasko**

Te ardhurat qe Bashkia ka mbledhur nga taksat nuk jane investuar ne fshat dhe kerkojme qe me keto lek qe jane mbledhur te investohen per fshatin.

- **Tac-Poshte Xhelal Veizi**

Nuk kemi problem me rrugen por aty mungon nje tabele orientuese qe edhe makinat te kthehen ne rruga e duhur. Ndricimi eshte problem pasi vetem tre llamba ndricuese duhen. Uji ne nikollaqi vazhdoj te ngelet problem.

- **Kryeplaku Psar**

Dashmor Kapo

Kemu problem tokat qe jane zene nga rruga e re qe do te behet dhe a do na demshperbleje per tokat tona.

- **Tac- Poshte Taulant Osmani**

Kemi problem taksen e turizmit pse ta paguajme ne kete takse kur nuk jemi fshat turistik. Ndricimi , nuk kemi dhe nq duhen tubot per ne kanali ne mes te fshatit. Lumi dhe pritat qe duhet te behen aty pasi ai permbyt tokat dhe fshatrat, nuk i mbjellim dot. Une kam 70 krere lope dhe kerkoi kullote , nuk me jane plotesuar nevojat per parcela dhe shteti nuk me dha subvencionet qe me takojne.

- **Borove Pandeli Qoku**


Kemi problem hapjen e lejes se druve pasi ketej fillon e ftohta shpjet dhe tetori qe hapet leja eshte shume vone, kerkojme qe te hapet me pare.

- **Kryeplaku Rehove**

Spiro ( Altin) Zoto

Duam te na zevendesohen dritat e djeguara rrugore me te reja dhe problem jane ato qe kane bageti ne fshat. Leja e ndertimit te ndahen sipas kategorive.

## **FOTO – GALERIA E TAKIMIT**



Per tw shikuar te plete galerine e takimit kliko linkun:

<https://konsultimivendor.al/bashkia-kolonje-degjese-publike-nj-a-qender-erseke/>

*Hartoi dhe mbajti kete procesverbal:*

Sofika Rexhepi

*Sekretare e per gjithshme*

*Bashkia Kolonje*